

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 4159/prot.
/4

Datë 25/2 /2022

VENDIM
Nr. 6, datë 21.02.2022

“Për miratimin e tarifave për ndjekjen e procedurës së fitimit të titullit “Profesor i asociuar” dhe “Profesor”, në Universitetin e Tiranës”

Bazuar në ligjin nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, nenet 49 dhe 61; Statutin e UT-së, nenet 38 dhe 55; Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”; Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”; Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”; VKM nr. 112, datë 23.02.2018, “Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore “Doktor” dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë “Profesor i Asociuar” dhe “Profesor”, të ndryshuar; Udhëzimin e MASR nr. 29, datë 10.09.2018, “Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë”, të ndryshuar; si edhe në Vendimin nr. 01, datë 31.01.2022, të Senatit Akademik të Universitetit të Tiranës, në mbledhjen e datës 21.02.2022, Bordi i Administrimit të UT-së,

VENDOSI:

1. Të përcaktojë tarifën në vlerën 150.000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë, për ndjekjen e procedurës së fitimit të titullit akademik “Profesor i Asociuar” në Universitetin e Tiranës.
2. Të përcaktojë tarifën në vlerën 200.000 (dyqind mijë) lekë, për ndjekjen e procedurës së fitimit të titullit akademik “Profesor” në Universitetin e Tiranës.
3. Për aplikantët të cilët janë personel akademik me kohë të plotë, në Universitetin e Tiranës, tarifa përballohet nga të ardhurat e vetë institucionit.
4. Për aplikantët të cilët vijnë nga jashtë Universitetit të Tiranës, tarifa përballohet nga vetë aplikanti, ose nga institucioni nga vjen aplikanti, sipas marrëveshjes që palët kanë rënë dakort ndërmjet tyre
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet për të gjithë aplikimet që kryhen pas hyrjes së këtij vendimi në fuqi.

